

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	SafeJournalists: Kërcënimi me vdekje ndaj gazetarit Osman Stafa në Shqipëri duhet të hetohet urgjentisht
ADRESA	https://piranjat.al/aktualitet/safejournalists-kercenimi-me--ndaj-gazetarit-osman-stafa-ne-shq-i104043
BURIMI	piranjat.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 13:59:17 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	14 shtator 2026, 13:45:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8e50d5d7f2542d23c3b37f8c5b4368cffc101b2a3e7b7077252d601328d44406
TEKSTI	00c1046c02081dba2225c001779810cefd30a5307f1b2b97a9020c37dbbb66c5
PAMJA	9513ed8d936c28ef071c4297c3f03c89792b56ec0641c5a529b0c3d2b8ade104

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	893b5a9d7c8621ae5c62bcf8cb69a0cd205a9cda862bc23a16bf9036ce6f52eb
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	6e410cf6c3be6bd40f75161c1288a8066fcd1b6e7ab80a3c789507dd842f2954
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/893b5a9d7c8621ae5c62bcf8cb69a0cd205a9cda862bc23a16bf9036ce6f52eb>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [EDITORIAL](#)
- [EMISIONE](#)
- [INVESTIGIME](#)
- [AKTUALITET](#)
- [SOCIALE](#)
- [POLITIKË](#)
- [KOSOVA](#)
- [BOTA](#)
- [SHOWBIZ](#)
- [LIFESTYLE](#)
- [SPORT](#)

[SYRI LIVE](#)



Flash: **fëmijë, shkollë** Këtë 14 shtator dyert e shkollës **shkollë** dyert e shkollës **NUK ka pasur loitar** ka dyert heshjen në një intervistë **Koçeku: Kam** politike nga subjekte **pezuilon nga detyra** efektivin e **policia asnjë** meqë

[AKTUALITET](#)

SafeJournalists: Kërcënimi me vdekje ndaj gazetarit Osman Stafa në Shqipëri duhet të hetohet urgjentisht

Piranjat Përditësimi i fundit 14 Shtator 2026, 15:45



Rrjeti SafeJournalists dënon fuqishëm kërcënimin e drejtpërdrejtë me vdekje ndaj gazetarit të News24, Osman Stafa, dhe u bën thirrje autoriteteve shqiptare të identifikojnë urgjentisht personin përgjegjës, të përcaktojnë nëse kërcënimi lidhet me punën e tij gazetareske dhe të marrin të gjitha masat e nevojshme për garantimin e sigurisë së tij. Më 14 shtator 2026, Stafa paraqiti kallëzim penal pranë Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Kibernetike të Policisë së Shtetit, pasi kishte marrë përmes Facebook Messenger një kërcënim të drejtpërdrejtë me vdekje. Në mesazh kërcënohej se do të gjendej dhe vritej, ndërsa bëhej referencë edhe ndaj pamjeve që ai kishte publikuar së fundmi.

Sipas deklaratimit të Stafës në polici, më 8 shtator ai kishte filmuar dhe publikuar pamje nga një protestë pranë Kuvendit të Shqipërisë, ku shfaqeshin katër persona me veshje civile gjatë ndalimit të një protestuesi. Nisur nga përmbajtja dhe koha e dërgimit të mesazhit kërcënues, Stafa vlerëson se kërcënimi mund të lidhet me publikimin e këtyre pamjeve.

Rrjeti SafeJournalists i bën thirrje Policisë së Shtetit dhe organeve kompetente të prokurorisë të zhvillojnë një hetim të shpejtë, të plotë dhe efektiv. Provat digjitale përkatëse duhet të sigurohen pa vonesë, duhet të identifikohet personi që qëndron pas llogarisë dhe të hetohet plotësisht çdo lidhje e mundshme ndërmjet kërcënimit dhe punës gazetareske të Stafës. Autoritetet duhet gjithashtu të vlerësojnë nivelin e rrezikut ndaj gazetarit dhe, kur është e nevojshme, të marrin masat e duhura për mbrojtjen e tij. Rrjeti kujton se ky nuk është incidenti i parë serioz që përfshin Osman Stafën. Në dhjetor 2025, SafeJournalists dënoi një mesazh kërcënues të dërguar ndaj tij pas raportimeve mbi kushtet në Spitalin Onkologjik në Tiranë dhe kërkoi një hetim të shpejtë dhe efektiv. Në qershor 2026, Rrjeti reagoi gjithashtu ndaj një incidenti të raportuar me fyerje verbale dhe intimidim fizik ndaj Stafës pas një proteste qytetare në Tiranë.

Përsëritja e kërcënimeve dhe rasteve të intimidimit të raportuara nga Osman Stafa e bën edhe më urgjente nevojën për një reagim institucional të besueshëm dhe efektiv. Kërcënimi i fundit duhet të hetohet bazuar në faktet konkrete të rastit, ndërsa incidentet e mëparshme duhet të merren në konsideratë gjatë vlerësimit të nivelit të rrezikut dhe të masave mbrojtëse që mund të nevojiten.

Kërcënimet me vdekje ndaj gazetarëve mund të kenë pasoja serioze dekurajuese mbi raportimin dhe ushtrimin e rolit mbikëqyrës të medias në interes të publikut. Gazetarët duhet të jenë në gjendje të raportojnë nga protestat, të dokumentojnë veprimet e autoriteteve publike dhe aktorëve të tjerë dhe të raportojnë për çështje me interes publik pa frikën e kërcënimeve, intimidimit apo hakmarrjes.

Rrjeti SafeJournalists shpreh solidaritet të plotë me Osman Stafën dhe do të vazhdojë ta ndjekë nga afër rastin, përfshirë reagimin dhe veprimet e autoriteteve kompetente.

Artikuj te sugjeruar

AKTUALITET 14 Shtator 15:16

[Ilir Meta del nga kafazi i qelqtë/ Apeli i GJKKO pranon kërkesën: Gjatë seancave do qëndrojnë krah avokatit](#)

Gjykata e Apelit ka pranuar kërkesën e kreut të Partisë së Lirisë, Ilir Meta, për të dalë nga kafazi i qelqtë ...

AKTUALITET 14 Shtator 15:14

Kontroll blic me urdhër të SPAK-ut në sektorin ku mbahet Ergys Agasi. Gjenden pajisje wireless dhe alkool!

Një kontroll blic është urdhëruar nga SPAK, për kontrole të imtësishme në parburgimin e Bradasheshit në sekt...

AKTUALITET 14 Shtator15:00

Goditi me grusht në bark qytetarin, Skender Hita pezullon nga detyra efektivin e “Shqiponjave”

Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Skender Hita, ka reaguar pas publikimit të një videoje ku shfaqet një punonj...

Piranjat News AKTUALITET 14 Shtator14:23

Aksident në lagjen “18 Shtatori” Gjirokastrë, policia asnjë masë

Një tjetër aksident është shënuar sot në lagjen “18 Shtatori” në Gjirokastrë. Një automjet ka dal&eum...

Nga Elton Qyno AKTUALITET 14 Shtator14:15

A do të mbushet bregdeti i Semanit me parqe foto voltaike? Subashi hap 5 tendera për dhënie me qira të 391 mijë m2 tokë

Përmes 5 procedurave tenderuese të hapura në Ditën e parë të Shkollës, kryetari i bashkisë Fier, Armando Subashi, i ka...

AKTUALITET 14 Shtator13:37

SPAK me kërkesë të re për arrestimin e Ballukut? Berisha: Ka tension real mes Ramës dhe Lubisë! Dora e zezë e saj qëndron pas...

Kreu i PD-së, Sali Berisha, është pyetur nga gazetarët në lidhje me mundësinë që SPAK të dërgojë në...

AKTUALITET 14 Shtator13:21

“Do të vras, këtë ta garantoj”/ Kërcënohet me vdekje gazetari Stafa, AGSH kërkon hetim

Gazetari i News24, Osman Stafa, është kërcënuar me vdekje përmes një mesazhi të dërguar në llogarinë e tij n...

AKTUALITET 14 Shtator13:19

Aksident në aksin Fier-Ballsh/ Dy mjete përplasen te “Kthesa e Krapsit”, tre të plagosur dërgohen me urgjencë në spital

Një aksident i rëndë automobilistik ka ndodhur pak minuta më parë në aksin rrugor Fier-Ballsh, në vendin e njohur si &ldquo...

AKTUALITET 14 Shtator13:13

Ishte fshehur brenda kontejnerit me mish pule nga Brazili, zbulohet ngarkesa me 2 mln euro kokainë në Portin e Durrësit

Sasia prej 41 kilogramë e 350 gramë kokainë e ardhur nga Brazili është sekuestruar në Portin e Durrësit gjatë operacio...

AKTUALITET 14 Shtator12:48

Plagosi vjehrrin e ish bashkëjetueses, arrestohet daja i deputetes Zegjine Çaushi

Policia e Fierit ka vënë në pranga, dajën e deputetes së PS, Zegjine Çaushi, pasi Bledar Bakaj dyshohet se plagosi me drap&eum...

ME TE VIZITUARAT

BOTA 13 Shtator

"Kaos" në fluturimin Australi-Katar/ Dy burra p...

Një incident është regjistruar në bordin e një fluturimi nga Melbourne drejt Dohas, ku dy pasagjerë meshkuj u bënë agre...

AKTUALITET 13 Shtator

“Dil jashtë”, u përplas me Edi Ramën për “Terri...

Mes debateve dhe përplasjeve, kështu është zhvilluar mbledhja e kësaj të diele mes kryeministrit Edi Rama dhe komunitetit të...

AKTUALITET 13 Shtator

Të shtëna me armë pranë një lokali në Greqi, dy...

Shqiptari Alket Rizai, ish-bashkëpunëtor i të shumëkërkuarit grek Vasilis Paleokostas dhe i njohur për arratisjen dy herë m...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik

Për më shumë se tre dekada ieta e kravenkorrorit italian të antimafias Nicola Gratteri ka qenë nën hijen e kërcënimev...

video



Reagon Cllevio!






Reagon Clevio!



Matilda, Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!



Deklarata e Gjedit!



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.